



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0424

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga UD Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “SRAHEP” SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale” me numër të prokurimit 616-25-1179-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINËS”, më 16/07/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e “SRAHEP” SH.P.K. me nr. 2025/0424, e datës 30/05/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale”, me numër të prokurimit 616-25-1179-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PRISHTINËS”. Anulohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale”, me numër të prokurimit 616-25-1179-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PRISHTINËS”.
2. Komuna e Prishtinës mund të vazhdoj tutje me këtë aktivitet të prokurimit të përshkruar si në pikën I të këtij dispozitivi.
3. Kjo ankesë konsiderohet si çështje e gjykuar (Res Judicata) pasi që pretendimet ankimore në këtë ankesë janë të njëjta si në Vendimin PSh. Nr. 2025/0179 i dt: 14/05/2025, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, andaj ky rast konsiderohet si çështje e gjykuar “Res Judicata”.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “SRAHEP” SH.P.K.,
5. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet si pjesërisht, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e

Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 26.02.2025, “KOMUNA E PRISHTINËS” , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale” me nr. prokurimi: 616-25-1179-1-2-1.

Autoriteti Kontraktues në këtë rast ka zhvilluar procedurë të hapur të prokurimit lloji i kontratës furnizim vlera e parashikuar e kontratës: 100,000 €.

Me 24.05.2025, OE “SRAHEP” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 03.06.2025, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 30/05/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “SRAHEP” SH.P.K., me nr. 2025/0424 lidhur me aktivitetin “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale” me numër të prokurimit 616-25-1179-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Për këtë aktivitet të prokurimit është lëshuar vendimi i OSHP-se nr.179/25

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “SRAHEP” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim: Autoriteti kontraktues K.UVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES ka publikuar njoftimin për kontratë me titull: “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale, me nr. të prokurimit: 616-25-1179-1-2-1 dhe me nr të brendshëm 616-13-1-2-1. Pasi kemi shkarkuar njoftimin, kemi parë që Autoriteti Kontraktues ka paraqitur disa kërkesa të kualifikimit të cilat haptas favorizojnë ndonjë operator ekonomik të paracaktuar pasi që të njëjtat nuk janë në përputhje me dispozitat ligjore të legjislacionit të prokurimit sepse kërkesat nuk janë relevante me natyrën e procedurës së prokurimit në fjalë.

Autoriteti kontraktues tek kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare në nenin 8.I&8.2 në pikën 1 tek kapaciteti ekonomik dhe financiar ka kërkuar:!. OE ofertues duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme AK-së se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre viteve të fundit financiare ka qenë jo më pak se 200,000.00 euro 1. Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore të Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuar nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur.

Autoriteti Kontraktues në kërkesën e lartshënuar ka kërkuar që OE ofertues duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme AK-së se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre viteve të fundit financiare ka qenë jo më pak se 200,000.00 euro në këtë kërkesë AK ka bërë shkelje të dispozitave të prokurimit pasi që kërkesa e tillë tek kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare zvogëlojnë dukshëm konkurrencen si dhe iu pamundëson bizneseve ne zhvillim për të marrë pjesë ne këtë tender, Andaj kërkojmë që kërkesa në fjalë të hiqet.

Autoriteti kontraktues tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në nenin 9.1&9.2 në pikën 1 tek kapacitetit teknik dhe profesionale ka kërkuar: 1. OE-ik duhet të ofroj dëshmi se ka realizuar furnizime te ngjashme ne tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontratë) në vlerën prej 150,000,00 eurove

Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e furnizimeve.

Autoriteti Kontraktues në kërkesën e lartshënuar ka kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi se ka realizuar furnizime të ngjashme ne tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontratë) në vlerën prej 150,000,00 eurove në këtë kërkesë AK ka bërë shkelje të dispozitave të prokurimit pasi që kërkesa e tillë tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale zvogëlojnë dukshëm konkurrencën si dhe iu pamundëson bizneseve ne zhvillim për të marrë pjesë ne këtë tender, Andaj kërkojmë që edhe kjo kërkesa në fjalë të hiqet.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktues duke pasur parasysh që çmimi i kontratës është i një vlere të mesme ka vendosur kriteret diskriminuese edhe tek pikata tjera Në pikën nr. 2 ka kërkuar që: 2.OE ofertues duhet te caktoj një Menaxher te projektit i cili duhet te jete dizajner i Enterierit Inxhinier i diplomuar. ose Master - 5 vite përvojë pune pas diplomimit. 2. OE me vendim duhet të emëroj menaxherin e projektit me së paku 5 vite përvojë pune e dëshmuar me CV. diplomën mbi kualifikimin origjinale.

Këtu Autoriteti Kontraktues ka kërkuar OE ofertues qe duhet te caktoj një Menaxher te projektit i cili duhet te jete dizajner i Enterierit Inxhinier i diplomuar. ose Master- 5 vite përvojë pune pas diplomimit kjo kërkesë nuk është relevante me këtë natyrë të prokurimit pasi që për artikujt e kërkuar nga ju si A.K. i keni të specifikuara te gjitha dimensionet të cilat do punohen artikujt e kërkuar andaj edhe nga kjo kërkesë shihet qartë se A.K është vënë në lajthitje nga një O.E. Andaj kërkojmë që edhe kjo kërkesa në fjalë të hiqet.

Në pikën nr. 3 ka kërkuar që: 3. OE ofertues duhet të ketë një Inxhinier te diplomuar te Emergjencave ose master me se paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit, i cili duhet te jetë i certifikuar si Ekspert për siguri ne punë dhe mbretje nga zjarri.

Autoriteti kontraktues ka kërkuar që OE ofertues duhet të ketë një Inxhinier te diplomuar te Emergjencave ose master me se paku 5 vite përvoje pune pas diplomimit, i cili duhet te jetë i certifikuar si Ekspert për siguri ne punë dhe mbrojtje nga zjarri natyra e prokurimit ka të bëjë me Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale e cila kërkesë nuk ka të beje fare me natyrën e prokurimit pasi qe shumica e inventarit janë krejtësisht të leta për tu bërë transporti bartja dhe montimi i inventarit në këtë natyrë të prokurimit me titull: Furnizim me inventarit në Qendrat e Ndryshme Sociale nuk ka fare të bëjë me ekspertin e mbrojtës nga zjarri pasi qe bie ndesh me rregulloren e prokurimit duke kërkuar një ekspert i cili fare ska të bëjë me Furnizim

me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale, pra dhe tek kjo kërkesë ka kufizuar konkurrencën pasi që nuk i ka dhënë mundësi operatorëve ekonomik të cilët janë biznese të vogla që të marrin pjesë në këtë tender. Andaj kërkojmë që edhe kjo kërkesa në fjalë të hiqet.

Në pikën nr. 4. O.E. Ofertues duhet të ketë se paku pesëmbëdhjete (15) punëtorë tjerë ndihmës të angazhuar për këtë projekt të trajnuar për mbrojtje dhe siguri në punë Certifikatat Valide dhe 5 të tjerë për mbrojtje nga zjarri, Certifikatat Valide. 4.Të prezantohen Certifikatat Valide të bashkëngjitet lista e punëtorëve, të bashkëngjitet licenca e kompanisë që ka kryer trajnimin e punëtorëve .

Autoriteti Kontraktues tek kjo kërkesë haptas e kufizon konkurrencën pasi që ky projekt mund të realizohet edhe nga 2 punëtor tjerë ndihmës edhe kërkesa tjetër që OE duhet të ketë 5 punëtor për mbrojtje nga zjarri bie ndesh me natyrën e prokurimit pasi që natyra e prokurimit ka të bëjë me furnizim me inventar dhe jo me sigurime të objekteve jo me testime të pajisjeve që ndezin apo fikin zjarrin andaj shumë qartë shihet se Autoriteti kontraktues është vënë në lajthitje andaj kërkojmë që edhe kjo kërkesa në fjalë të hiqet.

Në pikën nr. 6. OE duhet të ofroj dëshmi nga prodhuesi (apo dileri) për ISO standarde si në vijim:

ISO 10002 2018 ISO TC 136 ISO 19682 2023 ISO 10204 EN 1335-1 EN 10901 2009+Al 2011 TS EN 10204 2007 TS ISO 21524 2021 Dëshmia: kopjet e ISO Certifikatave të kërkuara.

Autoriteti kontraktues ka vendosur kritere diskriminuese edhe në pikën 6 në të cilën ka kërkuar që Iso në vazhdim ISO 10002 2018 ISO TC 136 ISO 19682 2023 ISO 10204 EN 1335-1 EN 10901 2009+Al 2011 TS EN 10204 2007 TS ISO 21524 2021. Certifikata ISO 10002 2018 ka të bëjë me Menaxhimi i cilësisë - Kënaqësia e klientit si dhe TS ISO 21524 2021 2018 ka të bëjë me Testet e rezistencës ndaj zjarrit - Elementet e ndërtimit të ndërtesës - Kërkesat për perde aktive zjarri Pra edhe ky kriter është diskriminues pasi që disa prej certifikatave të kërkuara nuk kanë të bëjnë fare me këtë natyrë të prokurimit pasi që natyra e prokurimit në fjalë ka të bëjë me Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale dhe jo me menaxhimin e cilësisë ska të bëjë as me kënaqësinë e klientit si dhe ska të bëjë me Testet e rezistencës ndaj zjarrit ska të bëjë as me Elementet e ndërtimit të ndërtesës dhe as me kërkesat për perde aktive zjarri pasi që në projektin në fjalë ka të bëjë me prodhimin e mobileve apo inventarit dhe jo me ndërtimin e objekteve apo ndërtesave si dhe kërkojmë që edhe certifikatat tjera tek kjo kërkesa siç janë : ISO TC 136, ISO 19682 2023, ISO 10204, EN 1335-1 , EN 10901 2009+Al 2011, TS EN 10204 2007 të hiqen pasi që dukshëm zvogëlojnë konkurrencën dhe iu pamundëson kompanive të reja pjesëmarrjen në këtë tender.

Në pikën nr. 7. OE ofertues duhet të sjellë Listën e Pajisjeve, mjeteve, makinave teknike 1. Kamion transportues, 2. Furgon transportues, 2. Pickup, Lista e Pajisjeve, mjeteve, makinave teknike, mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve, pajisjeve teknike dhe kapacitetet tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit). Lista pajisjeve dhe mjeteve, makinave teknike të OE duhet të jetë origjinale . e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori

Ekonomik, duhet të ofroj si dëshmi, Fotografi , Specifikacion teknik, Libreza, për pajisjet që nuk regjistrohen të dëshmohen me dëshmim doganor të noterizuar ose Faturë. Autoriteti Kontraktues gjithashtu ka vendosur kushte të pjesëmarrjes të cilat janë diskriminuese. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që OE ofertues duhet të sjellë Listën e Pajisjeve, mjeteve, makinave teknike 1.

Kamion transportues, 2. Furgon transportues, 2. Pickup Lista e Pajisjeve, mjeteve. makinave teknike, mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve, pajisjeve teknike dhe kapacitetet tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje të Tenderit). Lista paisjeve dhe mjeteve, makinave teknike të OE duhet të jetë origjinale , e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik, duhet të ofroj si dëshmi, Fotografi , Specifikacion teknik, Libreza, për pajisjet që nuk regjistrohen të dëshmohen me dud doganor të noterizuar ose Faturë. Pra kërkesa që për pozicione të lartcekura të paraqitet fotografi apo të dëshmohen me dud doganor të noterizuar ose Faturë e kufizon në masë të madhe konkurrencën pasi që e drejton tregun për furnizim të këtyre materialeve vetëm nga një prodhues i parazgjedhur. Kjo paraqet edhe shkelje të dispozitave të nenit 7 të LPP-s pasi që diskriminohen prodhuesit tjerë si dhe ofertuesit të cilët planifikojnë që të marrin pjesë në këtë tender. Prandaj, kërkesa që O.E. të paraqesin Listën e Pajisjeve, mjeteve, makinave teknike të lartcekura duhet të hiqen pasi që sikur kemi cekur se edhe kjo kërkesë e favorizon vetëm ndonjë O.E. të caktuar dhe diskriminon prodhuesit apo O.E. tjerë.

Në nenin 8. OE të ofroj katalogun e produkteve me përshkrim të detajuar Katalog i nënshkruar dhe vulosur në të cilin duhet specifikuar të gjitha karakteristikat për të gjitha produktet, për produktet të cilat nuk i prodhon ofertuesi duhet të prezantoj autorizim nga prodhuesi apo marrëveshje për furnizim me ato materiale dhe kohen e garancionit.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje edhe tek kjo kërkesë pasi që bie ndesh me këtë natyrë të prokurimit dhe nuk është relevante me natyrën e prokurimit sepse të gjitha artikujt janë standarde dhe konsiderojmë se për produktet të cilat janë standarde nuk na duhet katalogu dhe inventarin mund ta prodhoj çdo Fabrikë e Mobileve por në këtë kërkesë kërkojmë që edhe kjo kërkesë të hiqet pasi që haptazi shihet se është vënë me qëllim të vënies në lajthim të OE. të interesuar.

Në nenin 9. OE ofertues duhet të sjellë Planin Dinamik, të detajuar për secilin pozicion. 9. Plani dinamik i detajuar i vulosur dhe i nënshkruar.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje edhe tek kjo kërkesë pasi që haptas e kufizon konkurrencë ndërsa shumë qartë shihet se Autoriteti kontraktues është vënë në lajthitje andaj kërkojmë që edhe kjo kërkesa në fjalë të hiqet.

Në nenin 10. OE të ofroj deklaratë garancinë për të gjitha produktet të paktën 1 vit OE të ofroj deklaratë të nënshkruar dhe vulosur ku përcaktohet numri i prokurimit dhe titulli i këtij aktiviteti të prokurimit duhet të jetë garancioni.

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje edhe tek kjo kërkesë pra kërkesa është e pa specifikuar dhe e pa qartë me qëllim të vënies në lajthim të OE të interesuar pasi që tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale autoriteti kontraktues ka kërkuar 1 vite garanciom por të njëjtën gjë nuk e ka kërkuar tek specifikat teknike pasi që në përshkrimin e çmimit është kërkuar 5 vite garancion andaj kjo kërkesë apo ky kriter duhet të hiqet menjëherë pasi që është bërë për të vënë në lajthitje një O.E. të interesuar.

Kërkojmë nga ju si Autoritet Kontraktues që ti hiqni kriteret diskriminuese sepse ne si palë e pa kënaqur kemi parashtruar edhe një herë kërkesë për heqjen e kriterëve diskriminuese dhe ku kemi parashtruar Ankesë në OSHP ku OSHP ka detyruar që AK të bëjë përmirësimin e dosjes së tender mirëpo AK ka vepruar ndryshe nga vendimi i marrur me nr: OSHP: 2025/0179 pasi që nuk ka bërë heqjen e kriterëve të cilat nuk kanë qenë relevante me natyrën e prokurimit por vetëm i ka edituar ato gjat parashtrimin të ankese në vrenjtëm se AK ka bërë shkelje edhe gjat

korrigjimit të Dosjes së Tenderit pasi që nuk ka zgjatur afatin për tenderim sipas rregullores së Prokurimit Publik por vetëm 9 ditë pas dorëzimit të vendimit nga OSHP si dha fare nuk e ka bërë Zgjatjen e afatit për sqarim shtesë vetëm e ka lënë afatin i cilin ka qen para korrigjimit të dosjes andaj konsiderojmë qe edhe kjo është shkelje e dispozitave të Prokurimit andaj kërkojmë edhe një herë të behte korrigjimi i dosjes se tenderit dhe te hiqen kriteret diskriminuese.

Gjithashtu edhe sasitë janë paraqitur në kundërshtim me sqarimin e KRPP-s për kontratat me njësi pasi që tek kontratat e furnizimit duhet të poentohet secili artikull në mënyrë që të dihet sasia e kërkuar.

Andaj, Kërkojmë që në përputhje me dispozitat e LPP-së të lartcekura të mënjaroni kriteret diskriminuese teknike të përzgjedhjes të cekura më lartë të cilat janë përfshirë në njoftim për kontratë dhe në dosjen e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë si dhe të zgjatni afatin për dorëzimin e ofertave përndryshe jemi të detyruar që të paraqesim ankesë në OSHP dhe do ti njoftojmë organet tjera kompetente.

Si dhe kërkojmë nga ju si Organi Shqyrtues i Prokurimit që ankesa tonë ta shqyrtoj me përpikëri të lartë dhe ta detyron Autoritetin Kontraktues Komuna e Prishtinës që ta bënë korrigjimin e kriterëve si dhe ti heqin kriteret diskriminuese pasi qe tek këto kriteret e këtij tenderi shihet qartë se i janë përgatitur Operatorit Ekonomik Wood Corporation pasi që edhe tek një projekt tjetër autoriteti kontraktues Komuna e Prishtinës ka vënë kriteret e ngjashme apo të njëjta me qëllimin e përfitimit te kundërligjshëm si dhe zhvatjen e paras publike andaj edhe njëherë lusim Organi Shqyrtues i Prokurimit të veproj në bazë te dispozitave dhe ta vlerëson ankesën tonë si të bazuar, më poshtë gjeni edhe dëshmitë në anë siç janë dhe si i kanë marr kriteret nga tenderët e më parshëm me anë të përfitimit të kundërligjshëm dhe zhvatjen e paras publike bashkangjitur gjeni dëshmitë ne bazë të fotografive.,

Autoriteti Kontraktues pas parashtrimit të kërkesës për heqjen e kriterëve diskriminuese e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit si dhe autoriteti kontraktues pas pranimit të kërkesës tonë për heqjen e kriterëve diskriminuese nuk e ka shqyrtuar brenda afatit (3) ditë si dh ende ska marr asnjë vendim duke vepruar në kundërshtim me të gjithë nenet dhe dispozitat e prokurimit publike duke i dëmtuar bizneset me faktin se AK është vënë në lajthitje nga OE WOOD Corporation me qëllimin e përfitimit te kundërligjshëm si dhe zhvatjen e paras publike, më poshtë gjeni edhe dëshmitë në anë të fotografive.,

Gjithashtu në nenin 61 paragrafin 61.3 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin publik është paraparë që: Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e parashtrimit të kërkesës, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informatave shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në nenin 60.2 të kësaj rregullore. Ky afat, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë. Autoriteti Kontraktues nuk e ka shqyrtuar fare kërkesën tonë, andaj konsiderojmë që është shkelur dispozita në fjalë.

Gjithashtu në nenin 63 paragrafi 63.2. është përcaktuar që Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtroj një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim.

Duke mos e shqyrtuar fare kërkesën tonë për rishqyrtim Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ka bërë shkeljen e paraparë në Nenin 97 Shkeljet e rënda paragrafi 97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:

e. Mos respektimi i rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.

p. Mosrespektimi i afateve kohore në nxjerrjen e vendimit në kërkesa për rishqyrtim dhe afateve kohore në rast të ankesave në OSHP. Andaj në përshtatje me nenin 91 paragrafi

91.1 pika b) kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të inicon procedurën për revokimin e certifikatës profesionale të prokurimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit në Autoritetin Kontraktues Komuna e Prishtinës.

Gjithashtu edhe sasitë janë paraqitur në kundërshtim me sqarimin e KRPP-s për kontratat me njësi pasi që tek kontratat e furnizimit duhet të poentohet secili artikull në mënyrë që t dihet sasia e kërkuar.

Lusim edhe njëherë që Organi Shqyrtues i Prokurimit të merr për bazë të gjitha pretendimet tona dhe të analizoj të gjitha faktet dhe dëshmitë që i kemi paraqitur në ankesë dhe të merr masa ndaj AK Komuna e Prishtinës pasi që të njëjtit po veprojnë në kundërshtim me ligjet e prokurimit publik.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “SRAHEP” SH.P.K., konsideron se Autoriteti kontraktues ka shkelur Neni 7 i LPP-së, Neni 27 i LPP-së, Neni 28 i LPP-së, Neni 51 i LPP-së, Neni 69 i LPP-së, Neni 4 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 17 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 24 i rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 25 i rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 7 i LPP-së, Neni 27 i LPP-së, Neni 28 i LPP-së, Neni 51 i LPP-së, Neni 69 i LPP-së Neni 4 i rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 17 i rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Neni 24 i rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Neni 25 i rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Duke u bazuar ne faktet dhe provat e lartcekura kërkojmë nga OSHP qe te aprovoj ankesën tone si te bazuar dhe te detyroje Autoritetin Kontraktues Komuna e Prishtinës qe te heq kriteret diskriminuese te cekura me larte.

Përgjigjja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim. Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, duhet sqaruar se me datë 14.05.2025 OSHP ka publikuar vendimin me nr. 2025/0179 përmes të cilit ka miratuar pjesërisht ankesën e parashtruesit lidhur me kërkesat e DT. Me datë 23.05.2025 autoriteti kontraktues ka publikuar formularin për korrigjimin e kërkesave të DT ashtu që ka adresuar të gjitha të gjeturat dhe konstatimet sipas vendimit të OSHP duke eliminuar apo ndryshuar/plotësuar të gjitha kërkesat që kanë mundur të jenë diskriminuese apo favorizuese. Kërkesat e mbetura në dosjen e tenderit jo vetëm që janë në përputhje të plotë me vendimin e lartcekur të OSHP, por si të tilla janë kërkesa absolutisht të domosdoshme dhe në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast

zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar secila një nga një dhe me këtë rast është gjetur se këto pretendime jo vetëm që janë të pabazuara në kuptim të kësaj kërkesë për rishqyrtim, por si të tilla tanimë ato janë trajtuar nga OSHP (pra bëhet fjalë për çështje të gjykuara) si dhe janë adresuar nga AK përmes formularit për korrigjimin e DT. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 05.06.2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0424/2025, ndërsa me datë 16.06.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/0424 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. “Autoriteti kontraktues pajtohet me raportin e ekspertizës . Ndërsa nuk OE nuk ka dhënë përgjigje me raportin e ekspertit shqyrtues

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “SRAHEP” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0424 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.

Shumica e pretendimeve ankimore të ngritura përmes ankesës 424/25 janë të njëjtat pretendime të cilat janë ngritur përmes ankesës 179/25 , e cila ankese është rekomanduar të aprovohet pjesërisht e bazuar nga eksperti shqyrtues, ku pastaj përmes vendimit 179/25 paneli shqyrtues ka aprovuar ankesën sipas rekomandimeve të ekspertit

Pas analizimit të ankesës dhe dosjes së tenderit, vlerësojmë se AK ka bërë korrigjimet e dosjes së tenderit sipas rekomandimeve të ekspertit, duke hequr kërkesat për pajisje prodhuese të inventarit (pasi kemi të bëjmë me furnizim nga OE mirëpo domosdoshmërisht prodhim nga OE-te), duke lënë kërkesa vetëm për pajisje që mund të përdoren në transport dhe montim të inventarit

Po ashtu AK ka hekur kërkesën për ISO certifikata nga OE-te dhe kërkesa për ISO standard përmes dosjes se korrigjuar kërkohet nga prodhuesi ose dileri.

Pretendimet tjera ankimore sa i përket qarkullimit minimal te kërkuar edhe me rastin 179/25 kemi rekomanduar te refuzohen te pabazuara ashtu rekomandojmë edhe tani, dhe për këtë qeshtje i rekomandojmë panelit ta trajtoj rastin si qeshtje e gjykuar.

Pretendimet tjera ankimore te cilat nuk janë ngritur përmes ankesës 179/25 vlerësojmë se janë te pabazuara ne kuptim te nenit 108/A par.3, nenpar.3.1, pasi të njëjtat është dashtë të ngritën në afatin e parë të parashikuar për dorëzim të tenderëve.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur që të mbështes përgjigjet e ekspertit shqyrtues, i cila po ashtu ka konstatuar se këto pretendime janë të gjykuara dhe AK ka respektuar në përpikëri rekomandimet dhe vendimin e OSHP nr. 2025/0179, andaj, PSH konsideron se kjo ankesë duhet të aprovohet si pjesërishtë e bazuar vetëm për faktin se në rastin paraprak ka pasur të drejtë por që nuk mund të ndikoj në ndryshim të njoftimit për kontratë pasi që tani të gjitha pretendimet e aprovuara me ankesën 2025/0179 janë përfillur nga AK, që dot të thotë se PSH e kualifikon këtë ankesë konform nenit 105.2.16 të LPP si çështje e gjykuar. Kështu që PSH vendos të lejoj AK që të vazhdoj tutje me këto kërkesa të Dosjen e Tenderit/ Njoftimin për Kontratë të Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale”** me numër të prokurimit: “616-25-1179-1-2-1”.

PSH konsideron se të gjitha autoritetet kontraktuese duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet te jenë padrejtësisht te rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e produkteve që plotësojnë nevojat adekuate të tyre, si dhe pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme te cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të

parapara në aktivitet.

Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse. Andaj, AK është përgjegjëse edhe për hartim të DT, sipas nenit 27 dhe 28 të LPP.

Paneli Shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të pjesërishtëm të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP. Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit. Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - SRAHEP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: